



SEECP ALBANIAN CHAIRMANSHIP  
REGIONAL OWNERSHIP IN ACTION



## CONNECT TO EUROPE TO CONNECT EUROPE (CECE)

### Përmirësimin e Hekurudhave si Motor i Rritjes Ekonomike në

### Evropën Juglindore

*Tiranë, 10 shkurt 2015*



Në kuadër të aktiviteteve të Presidencës Shqiptare të Procesit të Bashkëpunimit të Vendeve të Evropës Jug-Lindore (SEECP), u zhvillua në Tiranë konferenca rajonale: "Përmirësimi i hekurudhave - Motor i Rritjes

Ekonomike në Evropën Juglindore".

Takimi u organizua nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës e Republikës së Shqipërisë, në bashkëpunim me Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal(RCC), në kuadër të Presidencës Shqiptare të SEECP.

Në konferencë morën pjesë më shumë se 40 përfaqësues dhe ekspertë të niveleve të larta nga institucione të ndryshme të vendeve të rajonit. Pjesëmarrja e përfaqësuesve nga Komisioni Evropian, si nga Drejtoria Qendrore për Zgjerimin dhe ajo për Lëvizshmërinë dhe Transportin, si edhe bashkë me përfaqësuesit e Observatorit të Evropës Juglindore për Transportin (SEETO), i dhanë konferencës një kontekst të gjere në kuadër të përpjekjeve për të identifikuar projekte të përbashkëta në kuadër të rrjetit rajonal hekurudhor.

Z. Edmond Haxhinasto, Ministër i Transporteve dhe Infrastrukturës, në fjalën e hapjes, theksoi rëndësinë e një sistemi hekurudhor të zhvilluar, si një mundësi e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm dhe për krijimin e vendeve të reja të punës në rajon.

Konferenca u përshëndet dhe nga zv. Ministrja e Punëve të Jashtme të Shqipërisë, znj. Odeta Barbullushi, e cila theksoi rëndësinë e SEECP-së, si forumi më i rëndësishëm politik në Evropën Juglindore, ndërsa vuri në dukje rolin e Shqipërisë si kryesuese e kësaj nisme, si një ndërmarrje e rëndësishme politike dhe diplomatike. Ajo nënvizoi rëndësinë që kryesia jonë e SEECP-së i kushton projekteve të interkonjeksionit në rajon si kusht për përafrimin e tij me rrjetet evropiane të qarkullimit të mallrave, kapitaleve dhe njerëzve.

Takimi u fokusua në dy panele: "Reforma e Hekurudhave – si një spirancë për zhvillimin multimodal dhe ekonomik të Evropës Juglindore dhe një rritje e bashkëpunimit ndërkufitar" dhe " Prioritetet rajonale të hekurudhave: Nevoja e Infrastrukturës Përballë Mekanizmave të Mundshme Financiare".

Në deklaratat e pjesëmarrësve, u nënvizua rëndësia e konferencës si një ngjarje e veçantë në fushën e hekurudhave, për të ndarë eksperiencën në këtë fushë dhe për të diskutuar mënyrat se si mund të përmirësohet rrjeti hekurudhor i rajonit.